

SPECIFIKIMET TEKNIKE

OBJEKTI: PASTRIM, GRUMBULLIM DHE TRANSPORTIM I MBETURINAVE NE TERRITORIN E BASHKISE PRRENJAS

1 .Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 150 kontenerëve me volum 1.1 m3, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, 150 zbrazje kontenerësh/ditë .

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenerëve për grumbullimin e mbetjeve në zonat sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate. Te gjithë kontenerët do të sigurohen nga Kontraktori. Mirëmbajtja dhe siguria e kontenerëve do të kryhet nga Kontraktori.

2.Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, pastrimit, dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazjen e kontenerëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontener, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m2 rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenerëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenerët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapacitet të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Në çmimin njësi të largimit të mbeturinave urbane përfshihet gjithashtu edhe dezinfektimi në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo konteneri. Dezinfektimi ditor te behet pas zbrazjes së çdo konteneri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqerës me 5% përmbajtje klori.

3.Plani i vendosjes së kontenerëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenerëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar.

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenerëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontraktues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë

Handwritten signature

Handwritten signature

ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenerësh.
2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 4:00-8:00, me qëllim që në orën 8:00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

e. Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penaltite dhe gjoba për mospërmbushjen e tyre.

f. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të kontenerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasisë së depozituar të mbetjeve por gjithmone duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

4. Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenerierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 4 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penaltitete sipas parashikimit në Nenin "Gjoba dhe penaltitetet"

b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbejten hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe

Signature

Signature

Signature

punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues

d. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga konteneri në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazen e kontenerëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenerët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

e. Në qoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhen të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përvec shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit ai do të përballlet me penaltitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është ngjorëzish i detyrueshëm dhe në rast moszbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

5. Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

5.1 Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **2 (dy) copë**;

5.1.2 Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak **1 (një) copë** në rast dëmtimi

5.2 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenerët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenerëve, si dhe dëmtime të rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenerëve, operatori i shërbimitka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenerëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë kontenerët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenerëve.
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenerëve.

Emri dhe Titulli

Emri dhe Titulli

Emri dhe Titulli

- f. Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të të vendosë dukshëm numrat e pikave mbi njërin nga kontenerietapo ambientet e tjetër rreth pikës sipas "Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre".
- g. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe konteneriët duhet të shkruhet "Me ju për një qytet më të pastër". Gjithashtu në të gjitha makinat dhe konteneriët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblihdhen, orarin kur largohen mbeturinat dhe mesazhe për edukimin ambientat.

6.Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.

6.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahëdhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **49 416 m2** në njëhere ne dy ditë. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes (bashkëngjitur kësaj kontrate) dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate.

6.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:


- Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, III duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m
- Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.
- Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

6.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 6.00-8.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontratues mund të ndryshojë miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njërës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të



shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.

2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operation punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penaltite, gjoba dhe ndalesa për mospëmbushjen e tyre.

6.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operationet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në eficensë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrim të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballat me penaltite sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

f. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

Ervin Topi

AK

AK

g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

h. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

i. Nën terminin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike.

6.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahëtë rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

Punoi:

Marinela Vreto 
Arjan Topi
Gordana Karaj 
Bukuroshe Kanani
Mehmet Karriqi 